



Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), mbështetur në nenin 4 paragrafi 3.1 dhe nenin 16 të Ligjit Nr. 05/L-042 “Për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit”, si dhe në nenin 8 dhe nenin 11 dhe 13 të Rregullores Nr. 16/2025 “Për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit”, pasi shqyrtoi aplikimin e KRU “Mitrovica” Sh.A. me nr. 716/DL, datë 19.09.2025, së bashku me dokumentet mbështetëse dhe raportin e Komisionit për shqyrtimin e aplikimit, me datë 07.10.2025, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për zgjerim të zonës së shërbimit të KRU “Mitrovica”

1. Miratohet kërkesa e KRU “Mitrovica” Sh.A. me seli në Mitrovicë, me nr. 716/DL datë 19.09.2025, për zgjerimin e zonës së shërbimit lidhur me integrimin e katër komunave veriore: Zubin Potok, Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Leposaviq, në kuadër të licencës së shërbimit të KRU “Mitrovica”.
2. KRU “Mitrovica” Sh.A. pajiset me licencë të re të shërbimit me përmbajtje të ndryshuar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, e vlefshme nga data 07.10.2025 deri më 10.09.2026, përderisa obligohet të zbatojë kushtet e licencës dhe legjislacionin në fuqi.
3. KRU “Mitrovica” Sh.A. licencohet dhe është e obliguar të ofrojë shërbime në pajtim me nenin 4 të Rregullores nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, për këto kategori:
 - 3.1. Kategoria A: Shërbimet e Ujësjiellit;
 - 3.2. Kategoria B: Shërbimet e Kanalizimit;
 - 3.3. Kategoria C: Shërbimet e Ujërave të Ndotura.
4. Pavarësisht se ka siguruar furnizim nga resurset ekzistuese, KRU “Mitrovica” obligohet të sigurojë të gjitha lejet, pëlqimet dhe autorizimet e nevojshme nga institucionet përgjegjëse, në mënyrë që në zonat e integruara të sigurohet furnizim i qëndrueshëm me ujë pa rrezikuar furnizimin e përgjithshëm.
5. Shfuqizohet pika 4 e licencës së shërbimit nr. L-01/2018, datë 11.09.2018.
6. Këtij vendimi i bashkëngjitet dokumenti me nr. L-01/2/2025 (licenca e shërbimit) e ndryshuar dhe plotësuar.

Arsyetimi

Duke u bazuar në Vendimin Nr. 02/266, datë 08.08.2025 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin janë caktuar zonat e shërbimit për ofruesit e shërbimeve të ujit në Republikën e Kosovës, si dhe në kërkesën e KRU “Mitrovica” Sh.A., me numër 716/DL, datë 19.09.2025, për ndryshim të licencës me qëllim të zgjerimit të zonës së shërbimit dhe përfshirjen e komunave veriore, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar dhe raportin përkatës të Komisionit për shqyrtimin e aplikimit dhe duke marrë për bazë se kjo kërkesë është në përputhje me nenet 16 dhe 18 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si dhe me nenin 11 të Rregullores Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e

Shërbimeve të Ujit, të cilat përcaktojnë se ndryshimi i licencës lejohet në rast të ndryshimit të zonës së shërbimit dhe të planeve të konsolidimit të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, bazuar në dokumentet mbështetëse dhe zotimet e KRU “Mitrovica” Sh.A., si dhe në konstatimet e Komisionit për shqyrtimin e aplikimit, është vlerësuar se ndërmarrja disponon kapacitete të mjaftueshme teknike, operacionale dhe financiare për të ofruar shërbime në zonën e zgjeruar, duke ruajtur njëkohësisht cilësinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë për konsumatorët ekzistues.

Në këtë kuadër, Autoriteti ka marrë parasysh edhe faktin se kompania “Vodovod Ibar”, e cila deri më tani ka operuar në mënyrë të kundërligjshme në komunat veriore pa poseduar licencë të lëshuar nga ARRU, aktualisht nuk ushtron më veprimtari të rregullt në këto zona dhe ndodhet në proces gjyqësor lidhur me veprimtarinë e saj ilegale. Duke marrë parasysh nevojën emergjente për të garantuar vazhdimësi të shërbimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me ujë për qytetarët e asaj ane, ARRU ka vlerësuar se licencimi i KRU “Mitrovica” për shtrirjen e shërbimeve në këto komuna është një veprim i domosdoshëm, në përputhje me mandatin e saj ligjor dhe publik.

Duhet pasur parasysh se furnizimi me ujë të pijshëm të sigurt dhe të pastër përbën një të drejtë themelore të njeriut, e njohur nga dokumentet ndërkombëtare, përfshirë Rezolutën e Kombeve të Bashkuara Nr. 64/292, e cila njeh të drejtën për ujë të pastër dhe të sigurt si të drejtë themelore të njeriut. Kjo e drejtë është gjithashtu e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila obligon institucionet publike të sigurojnë kushte për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave themelore të njeriut.

Në këtë drejtim, licencimi i KRU “Mitrovica” për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit në komunat veriore konsiderohet si hap i domosdoshëm për garantimin e të drejtës së qytetarëve për furnizim të qëndrueshëm, të sigurt dhe të ligjshëm me ujë të pijshëm.

Në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ARRU vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet për ndryshimin e licencës, me qëllim të integritetit të plotë të komunave veriore në kuadër të zonës së shërbimit të KRU “Mitrovica” Sh.A., në përputhje me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe planin sektorial të konsolidimit.

Për arsyet e cekura më lart, Drejtoresha e ARRU-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi u dorëzohet:

- Arkivit të ARRU-së;
- KRU “Mitrovica”;
- Të gjitha Departamenteve të ARRU;
- Njësisë për Inspektim.



Drejtori i ARRU

Hajrije MORINA